



Republika e Kosovës Republika Kosovo • Republic of Kosovo	100
Institucioni i Avokatit të Popullit Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution	
Nr./Br./No.	775/2019
Nr.i fqi/Br.str./Nr.pg.	03105/19
Data/Datum/Date:	



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## RAPORT ME REKOMANDIM

A. nr. 925/2017

Ilir Gashi

në lidhje me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën  
C. nr. 3303/12

Drejtuar: Znj. Afërdita Bytyçi, Kryetare  
Gjykata Themelore në Prishtinë

Prishtinë, më 3 maj 2019

## **Qëllimi i raportit**

1. Ky Raport me Rekomandim ka për qëllim që t’ia tërheqë vëmendjen Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës C.nr.3303/12, e cila ka të bëjë me kthim borxhi dhe kompensim dëmi, pa vonesa të mëtutjeshme.
2. Ky report është i bazuar në ankesën individuale të z. Ilir Gashit (në tekstin e mëtejjmë *ankuesi*) dhe mbështetet në faktet dhe provat e ankuesit, si dhe në shkresat e lëndës, të cilat i ka Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

## **Baza ligjore**

3. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”
4. Po ashtu, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 8, përcakton: “*Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme përfunksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave.*”

## **Përbledhja e fakteve**

Faktet, dëshmitë dhe informatat të cilat i ka Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), mund të përbledhen si në vijim:

5. Më 19 dhjetor 2012, ankuesi kishte parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë (tani Gjykata Themelore në Prishtinë) kundër së paditurës E. B. për kthim borxhi dhe kompensim dëmi. Lënda është evidentuar me numrin C.nr.3303/12.
6. Që nga viti 2013 e deri në vitin 2017, ankuesi i është drejtuar me 8 urgjencia Gjykatës Themelore në Prishtinë, nëpërmjet të cilave ka kërkuar procedimin e lëndës, për të cilat nuk ka pranuar asnjë përgjigje.
7. Më 26 dhjetor 2017, ankuesi ka paraqitur ankesë (A.nr.925/2017) në IAP për zvarritje të procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë.
8. Më 17 korrik 2018, Avokati i Popullit i është drejtuar me letër kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, nëpërmjet së cilës ka kërkuar informata përfazën në cilën ndodhet procedura në çështjen e ankuesit dhe për veprimet që janë ndërmarrë nga gjykata, në mënyrë që rasti të procedohet brenda afatit kohor, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolleve të saj.
9. Më 29 gusht 2018, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga Gjykata Themelore në Prishtinë, në të cilën, ndër të tjera, thuhej se lënda e ankuesit është regjistruar në gjykatë më 19 dhjetor 2012. Por gjyqtarja e cila ishte e ngarkuar me këtë lëndë, më 30 nëntor 2017, ka kërkuar nga kryetarja e gjykatës përjashtimin e saj nga gjykimi i kësaj lënde, për shkak të konfliktit të interesit, pasi që me paditësin ka lidhje familjare. Me aktvendimin Agj.nr.1442/2017, i datës 5 dhjetor 2017, është aprovuar kërkesa e gjyqtares për

përjashtim nga shqyrtimi dhe vendosja në këtë çështje. Po më këtë datë, 5 dhjetor 2017, lënda i është ndarë në punë një gjyqtari tjetër, i cili do të veprojë sipas dinamikës së paraparë për zgjidhjen e lëndëve të vjetra.

10. Më 25 shkurt 2019, përfaqësuesja e IAP-së pranoi njoftim nga pala se ende nuk ka ndonjë lëvizje nga gjykata lidhur me lëndën e tij.
11. Deri në ditën e publikimit të këtij raporti, Gjykata Themelore në Prishtinë nuk ka marrë vendim për lëndën e ankuesit, e cila është e evidentuar me numrin C.nr.3303/12.

### **Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës**

12. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21, përcakton: “*Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore [...]*”.
13. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm përcaktohet me nenin 31.1 të Kushtetutës: “*Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*”
14. Po ashtu, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, e përcaktuar me nenin 54 të Kushtetutës, parashevë: “*Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose më ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.*”
15. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj), sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është dokument ligjor drejtpërdrejt i zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave, ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.<sup>1</sup> Ndërsa paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNj-së, garanton: “*Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njëri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm kohor.*”
16. Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat, në nenin 7, paragrafi 2, përcakton: “*Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë, në përpunhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor.*”
17. Ndërsa nen 7, paragrafi 5, i Ligjit për Gjykatat, përcakton: “*Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruuar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve.*”

### **Analiza ligjore**

18. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen në nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nen 22.

19. GjEDNj-ja, në disa raste, ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç është e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
20. Avokati i Popullit gjen se praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, në mes tjerash, aktgjykimin *Moldovan* dhe të tjerët kundër *Rumanisë*, më 12 korrik 2005, dhe aktgjykimin *Sienkiewicz* kundër *Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih aktgjykimin *Poitier* kundër *Francës*, më 8 nëntor 2005).
21. Avokati i Popullit, lidhur me mosinformimin e palës përkitazi me fazën në të cilën gjendet lënda e tij, gjen se, sipas vendimeve të GjEDNj-së, një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet sa u përket çështjeve të tyre, brenda një kohe të arsyeshme (shih aktgjykimin *Zimmermann* dhe *Steiner* kundër *Zvicrës*, 13 korrik 1983).
22. Sipas praktikës së GjEDNj-së (shih *Poiss v. Austria*, § 50; *Bock v. Germany*, §35), llogaritja e kohës për trajtim të një rasti gjyqësor fillon nga momenti i paraqitjes së padisë pranë gjykatës kompetente, e që në rastin konkret fillon të llogaritet nga data 19 dhjetor 2012, kur paditësi e ka paraqitur padinë në Gjykatën Komunale në Prishtinë (tani Gjykata Themelore në Prishtinë), e deri në ditën e publikimit të këtij rapporti.
23. Njëkohësisht, mungesa e mjeteve efektive në shkeljen e së drejtës për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme, siç është e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përbën shkelje të nenit 13 të Konventës [E drejta për zgjidhje efektive], i cili thotë: “*Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura me këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankım efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare.*”
24. Neni 13 i KEDNj-së pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që fillimisht t'i mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, duke vendosur një garanci shtesë për një individ, që bën të mundur që ai/ajo t'i gjëzojë të drejtat në mënyrë efektive. Nëse shikohet nga kjo perspektivë, e drejta e një individu për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efikase nëse nuk ekziston mundësia që së pari ta parashtrojë këtë ankesë pranë një autoriteti vendor. Kërkesat e nenit 13 mbështesin kërkesat e nenit 6 (shih aktgjykimin *Kudla* kundër *Polonisë*). Kështu, neni 13 garanton një mjet ankimimi efektiv pranë një autoriteti vendor për një shkelje të pohuar të kërkesave të nenit 6 për ta shqyrtuar një rast gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme. Pasi që rasti në fjalë ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm.
25. Sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit rikuhton se GjEDNj-ja disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë, në rastet kur palët në

procedurë nuk kanë mjete efektive për ankimim në rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore, përbëjnë kërcënëm për sundimin e ligjit brenda rendit ligjor vendor (shih aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999 dhe aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999).

26. Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij nenit është ekzistencë e një mjeti ligjor vendor që merret me substancën e “një ankesë të kontestueshme” sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. aktgjykimin në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih p.sh. aktgjykimin në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000).
27. Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalonin shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë ka ndodhur (shih aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*).
28. Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor, përmes të cilët ankuesi do të kishte mundur të ankohej për zvarritje të procedurës, për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit.

### **Konstatimet e Avokatit të Popullit**

29. Avokati i Popullit rikujton se, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, kohëzgjatja e procedurës llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore, e që në rastin konkret është nga data 19 dhjetor 2012, dhe konstaton se zvarritja e tillë pa vendim përfundimtar shkelë:
  - *Të drejtën për gjykim të drejtë, proces të rregullt, brenda një afati të arsyeshëm kohor të përcaktuar dhe të mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 6 të KEDNj-së.*
  - *Të drejtën për mjete efektive juridike të mbrojtura me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 13 të KEDNj-së.*
  - *Të drejtën për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të përcaktuara me nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.*
30. Duke u bazuar nga sa u tha më lart, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “[...] ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”, me nenin 16, paragrafi 8, të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilët: “Avokati i Popullit mund të jap rekomandime të përgjithshme përfunksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përvëç rastit kur ka zvarritje të procedurës”, dhe bazuar në analizën ligjore të mësipërme, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës, i:

**REKOMANDON**  
**Gjykatës Themelore në Prishtinë**

- Pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmerr të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C. nr. 3303/12.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*” ) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda qafatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjale*”), mirësisht ju lutemi të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

  
Me ndërime,  
Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit